



Tempus



Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Edukimit

DORACAK PËR PUNIMIN E DIPLOMËS – TEZËS SË MASTERIT

**për studentët e programeve ‘Mësimdhënia dhe
kurrikula’ dhe
‘Udhëheqja në arsim’**

Nëntor 2010

Përmbajtja

1. HYRJE	5
2. Informacione të përgjithshme për programet studimore të nivelit master në fushën e arsimit	7
2.2. Programet “Master i Mësimdhënies dhe Kurikulës” dhe “Master i Udhëheqjes në Arsim” në Universitetin e Prishtinës/Fakulteti i Edukimit	8
2.3. Punimi i diplomës – teza e masterit	12
2.4. Kriteret e vlerësimit të temës së masterit	15
3. Projektpropozimi i temës së punimit të tezës së masterit	18
3.1. Përmbajtja e projekt-propozimit të tezës së masterit	18
4. Plagjiatura dhe etika hulumtuese	27
5. Shtojcat: Shabllonet dhe formularët	29
5.1 Aplikacioni për projekt-propozimin e punimit të tezës së masterit	29
5.2. Hartimi i deklaratave etike (shembuj)	30
5.3. Struktura dhe organizimi i sugjeruar i tezës së masterit	31

1. HYRJE

Punimi i diplomës për master përmban 30 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të programeve *master* në Fakultetin e Edukimit. Ky doracak është një material i rëndësishëm dhe orientues që përqëndrohet në shkathtësitë dhe strategjitë e nevojshme për planifikimin, punën kërkimore, analizën dhe shkrimin e tezës së masterit në programet “Mësimdhënia dhe Kurrikula” dhe “Udhëheqja në Arsim”.

Punimi i tezës për master, si fazë përfundimtare e studimeve në nivelin e dytë, u mundëson studentëve të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për organizimin dhe përfundimin e një projekti kërkimor.

Punimi i tezës është një projekt që duhet realizuar sipas rregullave e që tregon mënyrën se si ai prezantohet. Tema për shkallën *master* dallon nga format e tjera të shkrimeve për faktin se në këtë nivel situatat analizohen në kuptimin e një “pasqyre” më të gjerë. Nëpërmjet saj bëhen krahasime, shpjegohet një dukuri apo çështje e caktuar dhe arrihen përgjithësime të cilat mund të përdoren për të zgjeruar teoritë. Zakonisht, punimet më të suksesshme janë ato të cilat janë më specifike dhe që trajtojnë një problem në mënyrë të detajuar.

Angazhimi në punë të pavarur, bashkëpunimi ndërmjet studentëve dhe puna me mentorin/en (udhëheqësin) janë të pashmangshme gjatë një pune kërkimore. Prandaj planifikimi me kujdes i punimit të tezës dhe kohës së realizimit të secilës fazë duhet të bëhet me kujdes të veçantë. Shkrimi i tezës kërkon angazhim sistematik për të reflektuar në mënyrë analitike dhe kritike, për të përmbledhur dhe për të shprehur të menduarit në mënyrë të qartë. Pikërisht, ky doracak paraqet një ndihmesë dhe udhëzim për realizimin e këtij procesi.

Ky doracak duhet të lexohet, jo vetëm para se të fillohet me

projektin kërkimor apo studimin kritik, por është e nevojshme të konsultohet gjatë gjithë procesit. Një gjë e tillë e lehtëson punën kërkimore dhe natyrisht mundëson shfrytëzimin më efikas të kohës së konsultimeve me mentorin dhe realizuesin e projektit.

Doracaku ofron një metodologji të përshtatshme dhe paraqet në mënyrë të hollësishme të gjitha fazat e përgatitjes së punimit të tezës, por jo edhe udhëzime për analizën e të dhënave apo për metodat e hulumtimit. Në lidhje me këto çështje, studentët duhet të konsultojnë literaturën dhe mentorin.

Doracaku mundëson:

- Njohjen me qëllimin e një projekti kërkimor, rëndësinë e punës efektive me mentorin dhe menaxhimin e kohës në mënyrë racionale;
- Përmbledhjen e shkurtër të çështjeve të lidhura me planifikimin, realizimin dhe dorëzimin e tezës;
- Paraqitjen e punës që ndihmon në përcaktimin e një teme të përshtatshme të diplomës – *tezës master*.
- Paraqitjen e strukturës së punimit të diplomës dhe cilësinë e të shkruarit;
- Vlerësimin e punimit sipas kritereve të përcaktuara.

2. Informacione të përgjithshme për programet studimore të nivelit master në fushën e arsimit

1.1 Korniza e kualifikimeve në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë

Në Bergen (2005), ministrat europianë përgjegjës për arsimin e lartë e miratuan “një kornizë të përgjithshme për kualifikimet në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, e cila përbëhet prej tri cikleve (duke përfshirë edhe mundësinë e kualifikimeve të ndërmjetme brenda kontekstit kombëtar), përshkruesve të përgjithshëm për secilin cikël duke u mbështetur në rezultatet mësimore dhe në kompetenca dhe prej numrit të kredive për ciklin e parë dhe të dytë” (Bergen Communiqué, 2005). Ata u zotuan në harmonizimin e kornizave kombëtare për kualifikime me kornizën e përgjithshme për kualifikime. Korniza e përgjithshme përfshin definicione të ashtuquajtura *Përshkruesit e Dablinit* dhe fjalitë në vijim janë me rëndësi të veçantë për programet *master* në mbarë vendet e përfshira në procesin e Bolonjës:

Kualifikimet që nënkuptojnë përfundimin e ciklit të dytë u jepen studentëve:

- o që kanë treguar njohuri dhe të kuptuar që mbështetet, zgjerohet dhe/ose zhvillohet, e që zakonisht janë të lidhura me ciklin e parë, dhe që ofron bazën apo mundësinë për origjinalitet në zhvillimin dhe/ose zbatimin e ideve, shpesh në kuadër të kontekstit hulumtues;
- o që kanë zbatuar njohuritë dhe të kuptuarit e tyre dhe kanë aftësi në zgjidhjen e problemeve në rrethana të reja

dhe të panjohura brenda konteksteve më të gjera (ose shumëdisiplinore) lidhur me fushën e tyre të studimit;

- o që kanë aftësi për t'i integruar njohuritë, të merren me çështjet komplekse dhe të formulojnë gjykime me informacione të paplota apo të kufizuara, por që përfshijnë reflektimin mbi përgjegjësitë shoqërore dhe etike të lidhura me zbatimin e njohurive dhe të gjykimeve të tyre;
- o që mund t'ua komunikojnë përfundimet e tyre, njohuritë dhe arsyet që e krijojnë bazën e tyre, specialistëve dhe audiencës jospécialiste në mënyrë të qartë dhe pa dykuptimësi;
- o që kanë shkathtësi për mësim që u mundëson atyre t'i vazhdojnë studimet në mënyrë autonome dhe autodidakte.¹

Në kuadër të procesit të Bolonjës është dhënë propozimi (në vijim) si udhëzim për lidhshmërinë e pikëkredive me kualifikimet brenda kornizave kombëtare:

"Kualifikimet e ciklit të dytë mund të përfshijnë apo të përfaqësohen prej 90-120 pikëkredive ECTS – pragu minimal në ciklin e dytë duhet të mbërrijë në 60 pikëkredi ECTS" (ibid., f. 72).

2.2. Programet "Master i Mësimdhënies dhe Kurikulës" dhe "Master i Udhëheqjes në Arsim" në Universitetin e Prishtinës/Fakulteti i Edukimit

Programet "Master i Mësimdhënies dhe Kurikulës" dhe "Master i Udhëheqjes në Arsim" janë zhvilluar në kuadër të Projektit TEMPUS JEP 144677, financuar nga Komisioni evropian. Universitetet partnere, si përfituese në projekt janë: Universiteti i Prishtinës (Kosovë), Universiteti i Tiranës (Shqipëri) dhe

¹ *A Framework for Qualifications of the European Higher Education Area*. Bologna working Group on Qualifications Frameworks. Copenhagen, 2005, pp. 67-68 (ISBN 87-91469-53-8).

Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë (Maqedoni), ndërsa Universitetet nga Bashkimi Europian janë: Universiteti Roma Tre (Itali) si grantmbajtës, Universiteti i Aarhusit (Danimarkë) dhe Universiteti i Notinghammit (Angli). Në projekt janë angazhuar edhe një numër ekspertësh nga Sllovenia, Anglia dhe Ukraina.

Programi **“Master i Mësimdhënies dhe Kurikulës”** fokusohet në kurrikulat dhe në procesin e mësimdhënies, me qëllim të përgatitjes së individëve që do të shërbejnë si ekspertë në profesionin e tyre. Ky program është planifikuar për studentë që duan t’i thellojnë njohuritë dhe zhvillojnë kapacitetet e tyre për të reflektuar në mënyrë kritike mbi teoritë e zhvillimit të kurrikulës, hulumtimet në arsim dhe praktikën e tyre profesionale, si dhe duke i aftësuar ata të përballen me sfidat e profesionit të mësimdhënies.

Programi ka për qëllim:

- të përgatisë studentët të jenë kontribuues aktivë në procesin e hartimit dhe të rishikimit të kurikulave si dhe zbatimin sa më efektiv të tyre, duke pasur për bazë qasjen: *mësimdhënia me nxënësin në qendër*;
- të përgatis udhëheqës të ndryshimeve arsimore në klasë dhe në shkollë, me theks të veçantë në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit;
- të zhvillojë aftësitë e studentëve për të zbatuar programe mësimore që ofrojnë një ambient të përshtatshëm për të mësuar;
- të zhvillojë kapacitetet e studentëve për zbatimin e strategjive bashkëkohore të mësimdhënies në karrierën e tyre profesionale;
- të përgatisë studentët që të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të institucioneve të tyre.

Pas përfundimit të programit **Master i Mësimdhënies dhe**

Kurikulës studentët do të jenë në gjendje:

1. të kontribuojnë në zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulave duke marrë parasysh vlerat, politikat dhe kontekstin arsimor si dhe qasjen *“mësimdhënia me nxënësin në qendër”*;
2. të komunikojnë në mënyrë efektive me prindërit, mësimdhënësit, udhëheqësit e shkollave dhe palët e tjera të interesit për të siguruar zhvillimin e vazhdueshëm të shkollës;
3. të zbatojnë metodat bashkëkohore të mësimdhënies, duke përfshirë edhe aspektet e planifikimit dhe të vlerësimit në klasë, duke pasur për bazë qëllimet e kurikulës kombëtare në funksion të krijimit të një ambienti të përshtatshëm për të nxënë;
4. të zbatojnë bazat teorike të metodave të hulumtimit sasior (kuantitativ) dhe cilësor (kualitativ) në shkollë dhe në arsim në përgjithësi dhe t’i vënë këto në shërbim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet në klasë;
5. të analizojnë përvojat vendore dhe ndërkombëtare mbështetur në teoritë dhe praktikën e mësimdhënies, nxënies, zhvillimit të kurrikulave dhe të reflektojnë për ndikimin e tyre në praktikën e tyre profesionale;
6. të analizojnë procesin e zhvillimit të kurrikulave (planifikimin, zhvillimin, vlerësimin dhe rishikimin) dhe të vlerësojnë ndikimin e tyre në vlerat arsimore, shoqërore, kulturore dhe politike.
7. të integrojnë teknologjinë informative dhe komunikuese në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies në shkollë me qëllim të përmirësimit të të arriturave të nxënësve.

Nga ana tjetër, kërkesa në rritje për të kualifikuar udhëheqës dhe administratorë kompetentë, tashmë është bërë pjesë e pandashme e sistemeve të arsimit modern në mbarë botën. Në një kohë të ndryshimeve të shpejta roli i administratorëve dhe udhëheqësve në arsimin parauniversitar është i një rëndësie të veçantë në kontekstin e avancimit të vazhdueshëm të

institucioneve arsimore dhe shndërrimit të tyre në organizata të orientuara në ndryshime.

Procesi i Bolonjës është një aspekt tjetër që ka ndikuar në përgatitjen e mësimit dhe të administratorëve dhe udhëheqësve të institucioneve të arsimit parauniversitar. Ky proces përcakton një numër standardesh për arsimin e lartë, si për shembull, qasja e bazuar në kompetencë, krahasueshmëria e diplomave, kualifikimeve ndërshtetërore dhe zhvillimi i komponentës së hulumtimit shkencor në fushën përkatëse. Kështu, programi *Master i Udhëheqjes në Arsim* është hartuar mbi bazën e kësaj kornize duke marrë parasysh këto elemente:

- Trendët bashkëkohorë të zhvillimit dhe përmirësimit të shkollës si organizatë nga pikëpamja e rolit të administratës dhe udhëheqjes në këtë proces.
- Struktura dhe organizimi i tanishëm i përgatitjes së mësimit dhe të administratorëve në Universitetin e Prishtinës.
- Zhvillimet e fundit në aftësimin e mësimit dhe të administratorëve dhe udhëheqësve në nivelin *master* në Evropë.
- Përgatitja cilësore e mësimit dhe drejtorëve në shkollat e Kosovës në të kaluarën dhe tani.
- Konteksti dhe sfidat e drejtorëve në shkollat e Kosovës.
- Konteksti dhe sfidat e sistemit të arsimit në përgjithësi në Kosovë si dhe kërkesat në nivel të sistemit për kualifikimin shtesë të administratorëve dhe udhëheqësve në institucionet e arsimit parauniversitar dhe nevoja për shkathtësi shtesë për zyrtarët e administratës së arsimit parauniversitar.

Ky program ofron njohuri dhe zhvillimin e kompetencave të nevojshme për udhëheqës dhe administratorë bashkëkohorë të institucioneve të arsimit parauniversitar.

Pas përfundimit të programit studentët do të jenë në gjendje:

1. të identifikojnë nevojat zhvillimore dhe të ndihmojnë

- zbatimin e iniciativave zhvillimore duke u bazuar në teoritë, politikat, vlerat dhe përvojat arsimore;
2. të zbatojnë bazat teorike të metodologjive të hulumtimit sasior (kuantitativ) dhe cilësor (kualitativ) përkitazi me shkollën dhe arsimin në përgjithësi;
 3. të identifikojnë dhe analizojnë në mënyrë kritike problemet në arsim dhe t'i vendosin ato në kontekstin socio-kulturor për të sugjeruar zgjidhjet e mundshme;
 4. të hartojnë planin zhvillimor të shkollës/institucionit dhe të reflektojnë përkitazi me aspektet e zbatimit të tyre në praktikë me qëllim të përmirësimit të performancës së institucionit;
 5. të integrojnë teknologjinë informative dhe komunikuese në punën e institucionit të tyre dhe të reflektojnë përkitazi me ndikimin e saj në zhvillimin organizativ dhe përmirësimin e performancës së saj;
 6. të analizojnë strategjitë më të mira për administrim efikas të resurseve njerëzore, infrastrukturës fizike dhe aspekteve ekonomike të institucioneve të arsimit parauniversitar;
 7. të analizojnë dhe vlerësojnë përparësitë dhe mangësitë e stileve të ndryshme të udhëheqjes duke marrë për bazë kontekstin e sistemit shkollor në vend;
 8. të vlerësojnë programet arsimore dhe strategjitë e ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies sipas këndvështrimit të mësimdhënësit dhe udhëheqësit të institucionit arsimor;
 9. të vlerësojnë kontekstin në të cilin punojnë dhe të gjurmojnë metodat më të mira për adresimin e sfidave me të cilat përballet institucioni përkatës.

2.3 Punimi i diplomës – teza e masterit

Studimet *master* në Fakultetin e Edukimit përfundojnë me punimin dhe mbrojtjen e diplomës për master – *tezës së masterit*. Secilit student i lejoheq që të përgatisë dhe të dorëzojë tezën e masterit pasi ai/ajo t'i ketë përfunduar me sukses kurset e

programit të studimit. Punimi i tezës së masterit është një punë e përbashkët për studentët dhe mësime të mësimdhënësit.

Studentët në marrëveshje me mësime të mësimdhënësit i propozojnë Kolegjiumit të studimeve master një apo më tepër tituj temash për punimin e tezës së masterit me arsyetimin përkatës, të cilat i miraton Këshilli i Fakultetit me vendim të veçantë. Gjithashtu Këshilli i Fakultetit vendos për numrin e temave të diplomës – tezës master për të cilat një mësime të mësimdhënës mund të jetë mentor gjatë një viti akademik. (shih. Rregulloren mbi studimet për master).

Punimi i tezës së masterit përgatitet individualisht nga studenti. Ai/ajo do të bëjë një hulumtim të pavarur për një problem të fushës së arsimit përkitazi me fushën e studimit të programit për master (p.sh. mësime të mësimdhënësia e gjuhës; teknologjia e informacionit në arsim; administrimi i shkollës etj.). Studentët duhet të jenë të aftë të bëjnë hulumtim dhe të raportojnë përkitazi me tërë procesin e hulumtimit, që shpie në tekstin përfundimtar të tezës së masterit. Ata fillojnë me identifikimin e problemit të studimit, mbledhjen e të dhënave, metodat e analizës së të dhënave etj., dhe në fazat e mëvonshme i përshkruajnë rezultatet e hulumtimit, i sintetizojnë të dhënat në pjesën e përfundimit dhe ofrojnë rekomandime përkatëse.

Punimi i tezës së masterit u ofron studentëve para së gjithash:

- njohuri më të gjera dhe më të thella në një lëmë/fushë të veçantë;
- njohuri dhe përvojë në procesin e hulumtimeve;
- përvojë për të gjetur dhe hulumtuar burime të informacionit dhe për të përpunuar të dhënat;
- shkathtësi të mirëfillta për të interpretuar në mënyrë kritike një temë të zgjedhur;
- shkathtësi të mirëfillta në organizimin e rezultateve të një hulumtimi në formë të shkruar dhe gojore; etj.

Tema si një kontribut origjinal i dijes - Tema e shkruar në kuadër të programeve master në Fakultetin e Edukimit duhet të jetë

një kontribut thelbësor dhe origjinal i dijes. Kjo detyrë mbështetet në standardet akademike dhe aspektet metodologjike.

Mentorimi.- Secili student/e e ka të drejtë të zgjedhë një mentor. Mentori/ja duhet të ketë titullin profesor, i/e cila do të ndihmojë dhe udhëheqë punën e studentit. Në parim, mentori duhet të zgjidhet nga radha e profesorëve të fakultetit dhe që ka përvojë në fushën në të cilën do të shtjellohet tema e masterit. Pasi mentori ta pranojë tezën e masterit, studenti/ja i kërkon Këshillit të Fakultetit miratimin e atij bashkëpunimi.

Tema.- Rekomandohet që studenti t'i propozojë disa tema të mundshme dhe pastaj bashkë me mentorin/en të zgjedhin njërën prej tyre. Është e rëndësishme që në këtë fazë të hulumtohet literatura ekzistuese përkitazi me temën, në mënyrë që studentit të njihet me arritjet dhe diskutimet në atë fushë. Kur kandidati përfundimisht të ketë zgjedhur temën me pajtimin e mentorin, studentit duhet të paraqesë kërkesë zyrtare me shkrim për lejimin e temës së diplomës – tezës së masterit, të cilën e miraton Këshilli i Fakultetit.

Konsultimet.- Gjatë procesit të të shkruarit të punimit, studentit duhet të ketë konsultime të rregullta me mentorin e tij/saj. Nuk është mirë që kandidati të punojë një kohë të gjatë në mënyrë të pavarur dhe pastaj ta konsultojë mentorin dhe t'i dorëzojë një tërësi të madhe të punimit, pa marrë paraprakisht sugjerime për çështjet më të vogla. Konsultimet janë po ashtu edhe obligim i mentorit. Pra para përgatitjes së tezës përfundimtare, kandidati/ja është i/e obliguar që t'ia paraqes (së paku) një version mentorit dhe pasi ai/ajo të jetë pajtuar se punimi është i përfunduar, kandidati/ja e dorëzon punimin për shqyrtim.

Vlerësimi.- Kopja përfundimtare duhet të jetë e përgatitur mirë dhe e kompletuar kur ajo i dorëzohet anëtarëve të komisionit për vlerësim. Nëse ka komente të shumta, atëherë kandidati duhet ta korrigjojë serish temën, e nëse jo, Këshilli i Fakultetit merrë vendim që ta organizojë mbrojtjen: caktohet data dhe ajo

shpallet publikisht. (Neni 30 i Rregullores së studimeve master)

Mbrojtja - Studenti e mbron temën e masterit me gojë para një komisioni të emëruar nga Këshilli i Fakultetit. Rregullat për procedurat e mbrojtjes janë të përcaktuara në Rregulloren e studimeve për master. Studentit i jepet kohë prej 15-30 minutash për t'i paraqitur rezultatet e hulumtimit të tij (duke përdorë teknologji të informacionit si dhe teknika të tjera sipas nevojës); pastaj komisioni i parashton pyetjet. Pyetjet shpeshherë mund të parashtrohen edhe prej pjesëmarrësve të tjerë (publikut). Kandidati ka të drejtë të kërkoj pak kohë në mënyrë që t'i përgatisë përgjigjet (zakonisht deri në 30 minuta). Komisioni i dëgjon përgjigjet dhe jep komentet e tij lidhur me to, ose kërkon shpjegime shtesë. Në parim, nuk mund të bëhen pyetje çfarëdo qofshin ato. Në fund, komisioni tërhiqet për konsultim për ta vlerësuar punimin e shkruar të kandidatit dhe mbrojtjen e paraqitur të tij/saj. Në fund kumtohet rezultati në mënyrë publike (shih. Rregulloren e studimeve për master).

2.4 Kriteret e vlerësimit të temës së masterit

Kriteret e vlerësimit ndryshojnë prej një universiteti në tjetrin, varësisht prej rregulloreve të brendshme, standardeve akademike të institucionit. Megjithatë ekzistojnë parametra universale për adresimin e vlerësimit të *tezës së masterit*. Në Fakultetin e Edukimit, për vlerësimin e temës së masterit, merren parasysh kriteret e mëposhtme:

2.4.1 Cilësia e shkrimit, organizimi, stili, parashtrimi dhe zhvillimi i ideve.

- Teza duhet të ketë 12 000 – 15 000 fjalë, në fontin 12, *Times Neë Roman, double-spaced*;
- Organizimi logjik;

- Diskutimi i mirëfilltë i problemeve dhe ideve;
- Përshkrimi i kujdesshëm i problemeve, çështjeve, apo pyetjeve të ngritura, duke përfshirë edhe metodologjitë e kërkimit, përdorimin e epistemologjisë së kërkimit etj;
- Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkimit, stil i përshtatshëm – formal dhe akademik);
- Lexueshmëria e diagrameve, grafikëve dhe ilustrimeve, qartësia e fotografive.

2.4.2 Rëndësia e problemeve, çështjeve apo pyetjeve të ngritura në punim

- Problemet, çështjet, ose pyetjet e ngritura kanë të bëjnë me probleme aktuale dhe të vazhdueshme të një fushe;
- Mundësia e studimit për të dhënë kontribute të reja.

2.4.3 Cilësia e analizës

- Analizë domethënëse e problemeve, çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në lidhje me informacionin, materialin dhe të dhënat e mbledhura;
- Marrja parasysh kufizimet dhe përgjithësimet e studimit.

2.4.4 Cilësia e përfundimeve dhe/ose të rezultateve

- Ndërlidhja e teorisë me praktiken;
- Parashtrimi i pyetjeve për hulumtime të mëtejme.

2.4.5 Ndërlidhja logjike, krijimtaria dhe origjinaliteti

- Artikulimi i shkëlqyeshëm i problemeve, çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në punim si dhe arsyetimi se problemet, çështjet dhe pyetjet e ngritura janë me vlerë për t'u studiuar.

2.4.6 Paraqitja gjithëpërfshirëse e literaturës ekzistuese

- Rishikim i literaturës që në mënyrë logjike dhe kreative artikulon: a) zhvillimin historik të problemeve, çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në studim; dhe b) drejtimit pedagogjike dhe perspektivat që kanë të bëjnë me temën;
- Trajtimi i literaturës së analizuar shkon përtej kufijve të përmbledhjeve, por në mënyrë kritike vlerëson kufizimet dhe mundësitë e literaturës së mëhershme në lidhje me studimin.

2.4.7 Parashtrimi logjik në paraqitje dhe metodologji

- Përshkruan dhe ofron arsye të përshtatshme, mundësitë dhe kufizimet e metodologjive, metodave të kërkimit dhe të epistemologjisë apo epistemologjive të kërkimit të shfrytëzuara në formulimin e kornizës konceptuale të punimit.

2.4.8 Përfundimi

- Në mënyrë kritike trajton përgjithësimin dhe zbatimin e studimit dhe kontributin e tij në zgjerimin e kufijve të kërkimeve të mëhershme, sa u përket të arriturave të reja.
- Temat e shkruara në gjuhën shqipe duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze, përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.

3. Projektpropozimi i temës së punimit të tezës së masterit

3.1 Përmbajtja e projekt-propozimit të tezës së masterit

Projekt-propozimi për temë të masterit merr “dritën e gjelbër” në Këshillin e Fakultetit. Projektpropozimi nuk duhet të kuptohet si një *kërkesë zyrtare*. Në fakt ai paraqet planin e hollësishëm kërkimor të studentit. Nëse ky plan është problematik në një apo më shumë segmente të tij, atëherë ka gjasa për mosrealizimin me sukses të tij. Për këtë arsye, hartimi i projektpropozimit duhet të merret si një detyrë shumë serioze. Në këtë fazë, mentori jep mbështetje të duhur.

Në përmbajtjen e një projektpropozimi të temës së masterit përfshihen:

3.1.1 *Titulli i temës*

3.1.2 *Abstrakti*

3.1.3 *Fjalët kyçe*

3.1.4 *Hyrja*

3.1.5 *Shqyrtimi i literaturës*

3.1.6 *Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit*

3.1.7 *Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza*

3.1.8 *Metodat dhe teknikat e hulumtimit*

3.1.9 *Rezultatet e hulumtimit*

3.1.10 *Literatura*

Projektpropozimi i temës së masterit nuk duhet të ketë më shumë se 7 faqe. Pjesa e kësaj përmbajtjeje është paraqitur dhe komentuar si më poshtë:

3.1.1 Titulli i temës

Titulli i temës duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë (rekomandim: në parim jo më i gjatë se 20 fjalë). Titulli duhet të përkojë me përmbajtjen e vërtetë të temës. Duhet shmangur fjalëve/shprehjeve të përgjithshme (abstrakte) dhe duhet përpjekur të përpilohet një titull konkret dhe specifik për fushën e studimit.

3.1.2 Abstrakti

Tema e hulumtimit paraqitet përmes një abstrakti: përkufizimi i problemit, pse është i rëndësishëm studimi i tij (në raport me diskutimet bashkëkohore të fushës së studimit), cila është hipoteza e përgjithshme, metodat, instrumentet dhe rezultatet e pritura. Në parim, abstrakti nuk duhet t'i tejkalojë 350 fjalë.

3.1.3 Fjalët kryesore (kyçe)

Fjalët kyçe janë terma përshkrues në lidhje me temën e hulumtimit. Në parim, duhet të jenë 5-6 fjalë. Fjalët kyçe vendosen të parat e pastaj shënohen ato më të veçanta.

3.1.4 Hyrja

Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit që paraqet thelbin e hulumtimit dhe shpjegohen arsyet që e kanë nxitur kandidatin/en për zgjedhjen e temës dhe të problemit të caktuar.

3.1.5 Rishikimi i literaturës

Në këtë pjesë kandidati bën një përshkrim të përgjithshëm të “fushës së studimit” dhe e vendos temën e propozuar në kuadër të saj. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të bëhet një përshkrim i përgjithshëm

dhe i shtjelluar hollësisht i hulumtimeve përkatëse (libra, artikuj, raporte hulumtuese) që janë bërë prej autorëve të tjerë (vendorë dhe ndërkombëtarë) me përqendrim në gjetjet dhe përfundimet e tyre. Hulumtimet e kohëve të fundit (p.sh. të botuara gjatë këtij dhjetëveçari) duhet të vendosen në radhë të parë. Kandidati/ja duhet ta bëjë të qartë se çfarë dihet në fushën përkatëse (në lidhje me temën apo problemin që dëshiron ta shtjellojë) dhe se çka nuk është trajtuar ende në mënyrë sistematike, apo cilat pyetje kanë mbetur pa përgjigje.

Një prej kërkesave kryesore të kësaj pjese është një *përshkrim i perspektivës teorike*. Në punën kërkimore gjithnjë fillohet prej të kuptuarit teorik që e mbizotëron fushën e caktuar. Paradigmat dhe konceptet teorike të autorëve/shkencëtarëve të njohur, jo vetëm që ndikojnë në hulumtimin (e ardhshëm), por ato shërbejnë si fillesa të një studimi në lidhje me një 'fushë' të caktuar.

Si rrjedhim, kandidati/ja duhet të vendosë se cilën "shkollë të teorisë", paradigma dhe koncepte teorike janë të përafërta me problemin që e ka parashtruar dhe që e mbështesin më së miri hulumtimin e tij/saj. Për të qenë më konkret: ky kapitull duhet të përfshijë një analizë të literaturës së përzgjedhur, për shembull, një paraqitje të ngjeshur të teorive/autorëve kryesorë dhe të monografive më të rëndësishme shkencore në lëmin e caktuar, pastaj citatat kryesore, etj. Po ashtu duhet të bëhet e qartë se pse këto teori janë të rëndësishme dhe të dobishme për hulumtimin e planifikuar.

Gjatë përgatitjes së këtij propozimi rekomandohet që kandidati të bashkëpunojë ngushtë me mentorin e tij/saj. Po ashtu është me rëndësi të theksohet se në këtë fazë fillestare të studimeve të masterit, kandidati e sheh se përse disa orientime të caktuara teorike janë aq të rëndësishme. Prandaj është shumë e rëndësishme që të investohet kohë dhe energji që prej ditës së parë të studimeve master.

3.1.6 Identifikimi, formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit

Problemi i hulumtimit duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. *Qëllimet e hulumtimit* duhet të jenë të harmonizuara me problemin. Parashtrimi i problemit dhe relevanca e tij duhet të jetë e lidhur në kuptim me perspektivën teorike, por edhe me hipotezat dhe metodat e parashikuara të kërkimit. Gabim i shpeshtë (apo më mirë të themi një pikë e dobët) në parashtrimin e propozimit të temës është që kandidatët në këtë kapitull nuk i lidhin gjithnjë këto formulime (apo balancohen) me formulimet në kapitujt e tjerë, p.sh., me perspektivën teorike, me hipotezat e parashtruara, me procedurat e zgjedhura teorike, etj. Kjo pjesë duhet të shtjellojë dhe përkufizojë shkurt konceptet kryesore që përdoren në tezën e masterit. Në fund, duhet të paraqitet në formë të shkurtër struktura e temës së masterit dhe se aktualiteti i saj i shoqëruar me një arsyetim duhet të jepet në formë të përmbledhur.

3.1.7 Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat duhet të formulohen në atë mënyrë që parimisht të mundësojë kontrollimin dhe verifikimin e tyre. Pyetja e hulumtimit duhet të formulohet qartë dhe duhet të sigurojë një përvijim premtues të hetimit në lidhje me një problem të caktuar, ose çështje të interesit arsimor. Ajo duhet të implikojë një hipotezë të hulumtimit që mund të verifikohet. Hipoteza e hulumtimit duhet të jetë e formuluar saktë, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia dhe kërkesat shtesë.

Një hipotezë që nuk është dhe që nuk mund të verifikohet në ndonjë mënyrë të caktuar *nuk është hipotezë*. Në hulumtimet empirike ato duhet të lidhen me fenomene të matshme dhe se kandidati duhet të jetë në dijeni të instrumenteve të cilat mundësojnë matje të tilla. Është me rëndësi të hartohen kritere të qarta dhe të pakontestueshme që e konfirmojnë apo e mohojnë një hipotezë. Në hulumtimet cilësore (kualitative) është e rëndësishme që të kuptohen drejt dukuritë e hulumtimit dhe

të tregohet se përvojat që reflektohen nga ato janë të tilla që pasqyrojnë të kuptuarit dhe lejojnë rrejdhime të mëtejme. Nëse përdorim hulumtime sasiore apo një përzjerje të të dyjave, është gjithashtu e rëndësishme të nxirret një numër kriteresh përmes së cilave një hipotezë pohohet ose mohohet.

Një shembull i mirë i pyetjes hulumtuese mund të jetë: *Çfarë ndikimi ka përjetimi i stresit të mësimdhënësve të shkollave të mesme të Prishtinës në arritjet e nxënësve?* Për të dhënë përgjigje në këtë pyetje, mund të formulohen një apo më shumë nënpyetje, si për shembull:

Pyetjes hulumtuese i shoqërohet një hipotezë, si për shembull: "Shumë mësimdhënës përjetojnë stres në punën e tyre". Nuk do të jetë e vështirë të gjenden argumente teorike si dhe anketa empirike të cilat e mbështesin një hipotezë që thotë se secili individ përjeton stres. Megjithatë, problemi i vërtetë brenda kësaj hipoteze qëndron në atë se ai është i përgjithësuar dhe nuk na thotë shumë në lidhje me mësimdhënësit apo stresin. Së pari, kriteri është i shprehur në mënyrë të paqartë (subjektive) përmes fjalës "shumë". Si të konfirmohet apo mohohet një hipotezë e tillë? Sa nënkuptohet me "shumë"? Ku është kufiri mes fjalëve "shumë" dhe "jo aq shumë"? Së dyti, kriteri i 'masës' – stresi- është i dykuptueshëm.

Ne të gjithë e përjetojmë stresin në një kohë apo në një tjetër. Është shumë normale dhe në sasi e intensitet të kufizuar se sa mund të jetë e dobishme për të ngritur nivelin e vetëdijes dhe për të aktivizuar trurin tonë që të stimulojë veprime të duhura. Por, nëse i nënshtrohemi stresit të "tejzgjatur" dhe intensiv, ai është i dëmshëm për mirëqenien tone dhe zakonisht ndikon negativisht në punën tonë. Kështu, kjo hipotezë ka nevojë të rishikohet për të bërë një konfirmim të mundshëm të tij, apo për ta refuzuar. Mund të thuhet për shembull kështu: "Statistikisht, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve përjetojnë stres të panevojshëm me rrejdhime në rezultate të dëmshme për çështjet

e rëndësishme arsimore”. Kjo hipotezë, mund të verifikohet në një kontekst të veçantë, për shembull në shkollat e mesme të larta të Prishtinës.

Njësoj edhe pyetja hulumtuese: “A përjetojnë mësimmshënësit stres në punën e tyre”? Do të ishte një pyetje jovalide dhe jo mirë e shkruar sepse është e padefinuar, e gjerë dhe mund marrë përgjigjet “Po” ose “Jo” dhe në këtë rast do të mund të konkludonim paraprakisht se përgjigja është “Po” meqë të gjithë njerëzit përjetojnë stresin dhe mësimmshënësit nuk bëjnë përjashtim.

Një shembull tjetër i një pyetjeje të mirë hulumtuese mund të jetë: *Çfarë ndikimi kanë metodat ndërvepruese të mësimmshënënies në zvogëlimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit e shkollave fillore të Kosovës ?*, ndërsa nënpyetje që ndihmojnë në përgjigjen e kësaj pyetjeje mund të jenë:

- a) *Çfarë metoda ndërvepruese përdorin mësimmshënësit në shkollat fillore?*
- b) *Çfarë ndikimi kanë metodat ndërvepruese në sjelljet e nxënësve?*
- c) *Çfarë ndikimi kanë metodat ndërvepruese në arritjet e nxënësve?*
- d) *Çfarë ndikimi kanë metodat ndërvepruese në motivimin e nxënësve?*

Përgjigjet e nënpyetjejeve japin përgjigjen ndaj pyetjes kryesore hulumtuese. Studentët inkurajohen që për pyetjen e tyre hulumtuese (për një tezë duhet të ketë vetëm një pyetje kryesore hulumtuese), t’i shtojnë disa nënpyetje për të zbërthyer pyetjen dhe një hipotezë e cila do të vërtetohet ose jo në fund të studimit.

3.1.8 Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit

Shumica e temave të diplomave në studimet themelore (nëse kërkohen) mbështeten më pak në metodologjitë kërkimore sfiduese. Në këtë rast, pyetjet më të shpeshta janë, p.sh. “sa prej

asaj” dhe me “çfarë cilësie”. Në nivelin e masterit, kërkohen të elaborohen pyetje kërkimore më sfiduese dhe, si rrjedhojë, duhet të zbatohen metodologji më të sofistikuara . *Kurse të veçanta* të nivelit master kanë për qëllim ta njohin kandidatin me këto metodologji. Nganjëherë, përveç bashkëpunimit të ngushtë me mentorin (udhëhëqësin), rekomandohet të bashkëpunohet edhe me ekspertë të tjerë.

Para së gjithash kandidati duhet ta përkufizojë *llojin e qasjes hulumtuese për problemin e zgjedhur*. Në raste kur tema e hulumtimit është kryesisht *teorike* dhe nuk kërkon metodologji empirike, ky kapitull i përfshin zakonisht këto elemente:

- Grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit (literaturës, dokumenteve, fotografive etj.);
- Përshkrimin e materialit të grumbulluar (theksi në idetë, format, historiain, etj.);
- Metodat që do të zbatohen (historike, krahasuese, fenomenologjike etj.);

Në raste kur tema e hulumtimit kërkon *metodologji empirike*, ajo përfshin elemente të tilla, si p.sh., një përshkrim të mostrës, instrumentet e matjes, procedurat e mbledhjes së të dhënave, përpunim statistikor, etj. Rekomandohet që kjo pjesë të përbëhet prej disa paragrafëve, p.sh:

- Mostra: çfarë lloj mostre do të përdoret; karakteristikat dhe parametrat kryesorë;
- Instrumentet matëse: kush i ka zhvilluar ato dhe kur; karakteristikat, vlerësimi;
- Procedurat dhe kushtet gjatë mbledhjes së të dhënave; zbatimi i instrumenteve;
- Përpunimi statistikor (pse, cilat hipoteza do të testohen etj.).

Kandidatët që do të punojnë me pyetësorë dhe intervista duhet (1) ta sigurojnë pëlqimin e mentorit (udhëhëqësit) të tyre dhe (2) t’i vlerësojnë shpenzimet dhe kohën e kryerjes së studimit të propozuar.

3.1.9 Rezultatet e pritshme të hulumtimit

Rezultatet e pritshme duhet të parashtrihen në raport duke u mbështetur në kapitujt e mëparshëm. Po ashtu, rekomandohet që kandidati t'i parashtrijë ato që pret, t'i kontribuojë njohurive ekzistuese, teorisë dhe praktikës së lëmit të caktuar.

3.1.10 Referencat dhe bibliografia

Mund të ekzistojnë dy lloj dobësish në këtë pikë: referenca/bibliografia e zgjeruar ose e mangët. Në përgjithësi, kërkohet vetëm literatura kryesore, si ajo vendore (në gjuhën e kombëtare), ashtu edhe ndërkombëtare (në gjuhët e huaja; revista shkencore, profesionale, monografi, etj.). Duhet të mbizotërojë literatura e kohëve të fundit (megjithëkëtë, në rastet kur veçmas shtjellohen probleme teorike përfshirja e materialeve 'klasike' është e domosdoshme' në bibliografi). Në pjesën më të madhe të rasteve mjaftojnë 25 deri 50 burime bibliografike, pasi duhet ta dimë se teza e masterit nuk është një përshkrim sistematik i një lëmi të caktuar; theksi duhet të jetë më i madh në natyrën e veçantë të problemit. Megjithatë, në disa raste (p.sh. përdorimi i zgjeruar i dokumenteve historike, metodologjive krahasuese, materialet e përdorura prej artikujve të mediave, etj.) mund të ketë më shumë se 50 njësi bibliografike. Parimi është që çdo burim bibliografik i përdorur (apo të cilit iu është referuar, i cili është cituar etj.) në tezën e masterit duhet të vendoset në bibliografi. Sërish konsultimi me mentorin (mbikëqyrësin) është i domosdoshëm.

Referencat dhe citimet duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association). Stili i referencave APA kërkon nga autorët që të saktësojnë aty për aty burimin e idesë përkatëse e jo të tregojnë vetëm në fund literaturën e përdorur. P.sh. Jones (1998) ka argumentuar – thënë se..., ose një mënyrë tjetër që t'i referohemi një burimi të tillë, duke vendosur në kllapa mbiemrin e autorit dhe vitin e botimit, duke supozuar se referenca e plotë jepet në fund në listën e bibliografisë. Një ide mund të parafrazohet ose të vendoset në thonjëza, nëse ideja kopjohet tërësisht nga burimi përkatës ose në rastet kur një ide parafrazohet

Një mënyrë tjetër për të saktësuar një burim të parafrazuar është që në fund të idesë në kllapa të saktësohet autori, viti i botimit dhe numri i faqes. Ndërsa, për secilin model të përmendur më lart duhet të jepet edhe referenca e tërë në fund të punimit të bibliografia. Pra, në bibliografi futen vetëm burimet që janë cituar diku në tekst dhe jo materialet që janë shfrytëzuar për lexim të përgjithshëm.

Më poshtë keni një shembull se si do të shkruhet në bibliografi referenca për libër (mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i librit, vendi i botimit dhe botuesi):

Calfee, R. C., & Valencia, R. R. (1991). *APA guide to preparing manuscripts for journal publication*. Washington, DC: American Psychological Association

Më poshtë keni një shembull se si do të shkruhet në bibliografi referenca për një artikull nga një revistë shkencore (mbiemri dhe emri i autorit, viti i botimit, titulli i artikullit, titulli i revistës, volumi, numri i faqeve):

Wegener, D. T., & Petty, R. E. (1994). Mood management across affective states: The hedonic contingency hypothesis. *Journal of Personality & Social Psychology*, 66, p. 1034-1048.

Mënyra për të shkruar referencën për një burim elektronik është si më poshtë: mbiemri i autorit, shkronja e parë e emrit, data/viti i botimit. Titulli i artikullit/materialit, volumi dhe numri nëse ekziston, data kur është marrë nga interneti, si edhe adresa nga është marrë. Psh.:

Bernstein, M. (2002). 10 tips on writing the living Web. *A List Apart: For People Who Make Websites*, 149. Marrë më 2 Maj, 2006, nga <http://www.alistapart.com/articles/writeliving>

Për më shumë hollësi rreth citimit dhe përgatitjes së referencave/bibliografive mund të konsultoni “*Publication Manual of the APA (American Psychological Association, 5th edition)*” (2001).

4. Plagjiatura dhe etika hulumtuese

Plagjiatura është një formë e mashtrimit akademik. Të gjithë studentët duhet të kenë të qartë kuptimin e nocionit plagjiaturë dhe të mënjanojnë plagjiaturën në punën e tyre gjatë studimeve. Plagjiaturë është kur një individ përdorë idenë e dikujt tjetër sikurse ato të ishin të tij. Kjo dukuri ndëshkohet rëndë në komunitetin akademik dhe për t'iu shmangur kësaj, studentët (dhe mësimmthënësit) duhet t'i referohen burimit të secilës ide që ata përdorin në punën e tyre.

Një rëndësi e veçantë gjatë punës hulumtuese duhet t'i kushtohet procedurave *etike*. Në të vërtetë, hulumtimet nuk ndodhin në një "kullë të fildisht". Ato kryhen në mjediset shoqërore dhe natyrore. Prandaj është me rëndësi që studentët të marrin parasysh standardet e etikës profesionale dhe t'i respektojnë ato në klasë dhe në mjedisin ku kryhet hulumtimi. Në të kundërtën, do të paraqiten pengesa dhe vështirësi gjatë gjithë procesit të hulumtimit. Shpeshherë, mbledhja e të dhënave personale mund të jetë një çështje shumë e ndjeshme për individët apo grupet shoqërore. Po ashtu, kryerja e eksperimenteve të ndryshme apo respektimi i normave ligjore shpeshherë shoqërohen me pengesa të ndryshme. Për këtë arsye është më se e domosdoshme që në çdo fazë të hulumtimeve të merren parasysh "etika hulumtuese" dhe integriteti akademik.

Parimet kryesore të etikës hulumtuese janë:

- Respektimi i dinjitetit njerëzor (trajtimi i personave në mënyrë të drejtë dhe respektimi i të drejtave të njeriut);
- Dobishmëria (përpjekje për cilësi dhe përdorim më të mirë të burimeve, jo shfrytëzim i pjesëmarrësve të hulumtimit etj) dhe
- Drejtësia (rëndësia e paanësisë, qasje e barabartë në përfitime,

respektimi i autorësisë, respektimi i individëve apo i grupeve të personave me nevoja të veçanta etj).

Gjatë punës hulumtuese, studentët duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të përpiqen:

- të pranojnë/njohin kontributet e burimeve tjera në përpjekjet e tyre studimore;
- të përfundojnë punën e tyre hulumtuese në mënyrë të pavarur;
- të ndjekin udhëzimet për punën hulumtuese duke respektuar standardet e disiplinës akademike dhe
- të shmangin angazhimet në cilëndo formë të pandershmerisë akademike.

Prandaj, para se të fillohet me punën hulumtuese, studentët duhet të marrin parasysh miratimin e deklaratave etike nga pjesëmarrësit e hulumtimeve të tyre.

5. Shtojcat: Shabllonet dhe formularët

5.1 Aplikacioni për projekt-propozimin e punimit të tezës së masterit

Universiteti i Prishtinës



UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS
Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovës
Tel:+381-38-244183 URL: <http://www.uni-pr.edu>
Fax: +381-38-244187 Mail: rektorati@uni-pr.edu

FAKULTETI I EDUKIMIT

Këshillit të Fakultetit të Edukimit

Kërkesë për lejimin e punimit të tezës së masterit

Propozim për tezën e masterit në programin “ _____ ”

Emri dhe mbiemri i studentit _____

Data e dorëzimit të kërkesës _____

Emri dhe mbiemri i mentorit _____

Titulli i propozuar i tezës së masterit: _____

Nënshkrimi i mentorit/es: _____ Nënshkrimi i studentit/es: _____

Projektpropozimi i *tezës së masterit* (jo më shumë se 7 faqe), sipas standardeve të defnuara në këtë Doracak, i bashkangjitet kërkesës.

5.2. Hartimi i deklaratave etike (shembuj)

DEKLARATA ETIKE

Unë, _____, premtoj se do të siguroj praktika të mira etike gjatë kryerjes së hulumtimit tim. Premtoj që në çdo kohë do të kërkoj lejen për kryerjen e hulumtimit, do të respektoj besueshmërinë dhe sigurojë të drejtën e pjesëmarrësve të tërhiqen në çdo kohë nga hulumtimi.

(Nënshkrimi juaj) _____

Adresa e institucionit tuaj
[data]

[Emri dhe adresa e prindit ose kujdestarit/es]

I/e nderuar

Kërkesë për leje të realizimit të hulumtimit

Si pjesë e punës sime me [emri i shkollës, ose emri i projektit], jam duke realizuar një hulumtim në klasë në lidhje me atë se si mund t'i inkurajoj nxënësit të përmirësojnë aftësitë e tyre për të shfrytëzuar kompjuterët.

Do të jem mirënjohës nëse mund të marr lejen Tuaj për pjesëmarrje në hulumtim të [emri i nxënësit].

Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme do të shfrytëzoj regjistrimet me zë dhe video-regjistrimet, fotografitë, ditarët e nxënësve dhe raportet. Ju premtoj se do të respektoj konfidencializmin në çdo rast, përveç nëse ju kërkoni ndryshe. Nëse jeni të interesuar për progresin e punës, do të ju informoj në çdo kohë.

Do të jem mirënjohëse nëse e nënshkruani këtë marrëveshje bashkëpunimi
Nga dy kopjet e dërguara, një do ta mbani për vete.

[Nënshkrimi Juaj] _____

[Emri Juaj] _____

Për [emri juaj]

Unë, [emri] ju premtoj që [emri i nxënësit - pjesëmarrës] do të marrë pjesë në hulumtimin tuaj.

[Nënshkrimi i prindërit/kujdestarit] _____

[Emri i prindërit/ose kujdestarit] _____

5.3. Struktura dhe organizimi i sugjeruar i tezës së masterit

1. Fleta e zbrazët
2. Titulli i temës (faqe 1, numri i faqes nuk shënohet)
3. Tabela e përmbajtjes (faqja/et e radhës e numëruar)
4. Lista e figurave (të numërohen sipas radhës)
5. Lista e tabelave (të numërohen sipas radhës)
6. Parathënie; falënderime
7. Teksti kryesor i temës së masterit.